

**AKT THEMELEMI**  
**I**  
**SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**  
**"AIGOT" SH.P.K.**

Tirane 20.01.2021

**NENI 1**

Ne Tirane, sot me daten 20.01.2021, ne baze te Ligjit Nr.9901 date 14.04.2008 'Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregetare' I ndryshuar dhe Ligjit Nr.9723 date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit", themelohet Shoqeria me Pergjegjesi te Kufizuar me emertimin "**AIGOT**" SH.P.K.

**NENI 2**

Ortaket themelues te shoqerise jane :

**Marina Hasa** me Nr. Karte indentiteti J35701029T e bija e Agronit dhe Behijes, e datelindjes 01.07.1993, lindur ne Lushnje dhe banuese ne Tirane, Rruga "Muhamed Deliu", Pallati ILAD, H1, 15. Linze, Njesia Administrative Dajt, TIRANE

**NENI 3**  
**Emërtimi**

Emërtimi i plotë i Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar eshte "**AIGOT**"

**NENI 4**  
**Selia**

Shoqëria e ka seline e saj në Tiranë, me adrese në Rr. "Muhamed Deliu", Nr. Pasurije 505/252 – N2/1, Kati i zero, Hyrja nr.1, Zona kadastrale 2460, Njesia Administrative Dajt, Tirane.

Pervec ushtrimit te aktivitetit ne nivel qendror, shoqeria ka te drejte te hap dege dhe zyra perfaqesimi brenda vendit ose jashte vendit.

Selia e Shoqerise mund te ndryshoje me vendim te Asamblese se Pergjitheshme.

**NENI 5**

**Kohëzgjatja**



Kohëzgjatja e shoqërisë është me afat të pacaktuar, dhe do të fillojë nga data e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit, me përjashtim të rastit kur mbaron sipas parashikimeve të ligjit ose kur vendos Asambleja e Përgjithshme.

## **NENI 6** **Objekti i Veprimtarisë**

Objekti i Veprimtarisë është:

- Konsulencë juridike dhe përfaqësim në institucione shtetërore në fushën civile penale, tregtare dhe administrative.
- Importi – eksporti, tregëti, shitja me shumicë, pakicë dhe online e pajisjeve elektronike, elektroshtepiake, elektrike, kompjuterike, kancelarike, konsumablave, pajisje teknologjike, sisteme për përpunimin e të dhënave të të gjitha llojeve, hardware, software dhe të gjithë periferikëve të tyre. Mirembajtje të produkteve sipër permendura, suport teknik. Shërbime kompjuterike. Servis kompjuterash dhe pajisjesh elektronike. Shërbime për riparimin e pajisjeve informatike dhe fotokopje për të tretë.
- Të projektoje dhe zbatoje rrjeta informatike për kompjutera dhe të nënshkruaje kontrata mirembajtje me ente private ose shtetërore.
- Shërbime konsulencë dhe kurse kualifikimi në fushën e teknologjisë së informacionit dhe administrimit të biznesit
- Të zhvillojë aktivitet në fushën e prodhimit dhe shitjes së software (programe), dizënim dhe zhvillim, projektim i detajuar i software dhe bazës së të dhënave, analize, zhvillim, programim (kodim), integrim i komponentëve, trajnime, instalime, konsulencë, implementime dhe të tjera ndihmëse në këtë fushë, ndjekje të proceseve, kolaudim, korigjim, deri në produktin përfundimtar duke realizuar zgjidhje informatike, plotësim i sistemit informatik me elementet e sigurisë, privatesisë etj, zhvillim në kohë të ndryshme, duke garantuar upgrade të sistemit për të realizuar komunikime me versione të ndryshme të sistemit informatik.
- Si dhe çdo veprimtari të tjera tregëtare në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi dhe në interes të shoqërisë.

## **NENI 7** **Kapitali Themeltar**

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100 000 Leke. Ky kapital është i përbërë nga një quote me vlerë prej 100 000 leke të nënshkruar nga ortakët i vetëm Marina Hasa. Ky është kapitali efektiv që nga regjistrimi i shoqërisë. Kapitali themeltar është depozituar në një Bankë në Shqipëri, me një llogari të hapur në emër të shoqërisë në formim e sipër.

## **NENI 8**

Administrator i shoqërisë do të jetë **Marina Hasa**



## **NENI 9**

Drejtimi, organizimi dhe funksionimi i shoqërisë rregullohet sipas dispozitave të legjislacionit shqiptar si dhe në bazë të Statutit dhe këtij Akti Themelimi të kësaj shoqërie.

## **NENI 10**

### ***Dispozita e fundit***

Ky akt themelimi është perpiluar në 2 (dy) kopje, në gjuhën shqipe, me vlerë të njëjtë ligjore.

**ORTAKU THEMELUES**

**Marina Hasa**

Handwritten signature of Marina Hasa in cursive script.